

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPECË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI PENAL, gjyqtari Musa Konxheli, me asistentin Muedin Rexhepi, në lëndën penale kundër V.K. nga fshati... komuna e Ferizajt, i akuzuar me aktakuzën e Ptokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1263-6/2017 të dt.04.08.2017, sipas së cilës e ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesës e Prokurorisë Themelore në Ferizaj për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, më dt.31.08.2017 solli

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.nr.1263-6/17 e dt.04.08.2017 dhe kjo gjykatë jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari **V.K.** nga fshati... komuna e Ferizajt, i lindur më data e lindjes... në të njejtin vend, nga i ati Z ... i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri,

ËSHTË FAJTOR

Sepse me dt.01.07.2017 rreth orës 18:00, në pyllin shoqërorë të cilën e menaxhon Drjtoria për Zhvillim Ekonomik në Shtërpce, në rajonin ekonomik pyjor në Kashtanjevë, në vendin w quajtur “ Parcela nr. 80” me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 1 trung të llojit ah, me dimension të gjatë 20 metra, me diametër 63 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 2.09 m³, cilat i ka transportuar me traktor Rakovicë, vlera e dëmit të shkaktuar është 282,15 €

- me çka ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

- Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së dhe nenit 495 të KPPRK-së,

G J Y K O N

Të akuzuarit **V.K.** i shqiptoi dënimin në shumën prej 200 € (dyqind Euro), të cilën shumë i akuzuari obligohet t'a paguan në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti do t'i shndërrohet në dënim me burg ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet nga një (1) ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës drejtorisë për Zhvillim Ekonomik në Shtërpce t'ia kompenzon dënim e shkaktuar në vlerë prej 282,15 €, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari të paguan shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, të gjitha këto nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP.nr.1263-6/17 të dt.04.08.2017 ka akuzuar V.K. nga fshati... komuna Ferizajt, se ka kryer veprën penale vjedhje pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së dhe ka parashtruar kërkesë për dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallximi panal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrit ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkeses për dhënien e urdhrit ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par.1.2 dhe 3 të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkëngjitura në shkresat lëndës gjegjësisht fletparaqitjes së ushtruar nga ana e Drejtorisë për Zvillim Ekonomik në Shtërpcë me nr.77/2017 të dt.10.07.2017 dhe procesverbalin me numër të njëjtë konstatoi se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzari ka kryer veprën penale pën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata në mbështetje të nenit 463 par.2 të KPRK-së e ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtorisë për Zvillim Ekonomik në Shtërpcë, t'ia kompenzon dënim e shkaktuar në shumë prej 282,15 €, në afat prej 15 ditësh nga dita plotëfuqishmirisë së këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është sjellë në bazë të nenit 450 par.2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEGA NË SHTËRPCË
P.nr.173/2017 i dt.31.08.2017.

Gjyqtari
Musa Konxheli

KËSHILLË JURIDIKE:

Kudër këtij aktgjykimi lejohet kundërshtimi në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të dërgesës së të njëjtit, gjyqtarit të vetëm gjykues të kësaj gjykate, përmes kësaj gjykate. Pas skadimit të afatit të lejuar për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor bëhet i plotëfuqishëm dhe ekzekutohet dënimi i shqiptuar.